



Oketa “kundër” Berishës

Vetëm 1500 km rrugë rurale do të financohen në 5 vitet e ardhshëm me 200-400 milionë dollarë.

Banka Botërore ka dhënë “OK” për financimin e projektit të rrjetit rrugor rural, i cili do të zgjasë pesë vjet. Por ndryshe nga sa tha kryeministri, BB-ja do të projektojë financimin deri në 1,500 km rrugë rurale, ndërsa kostoja totale arrin nga 200 deri në 400 milionë dollarë. Lidhur me kredinë, BB-ja do të japë vetëm 20 milionë dollarë dhe jo 400, sa kishte thënë kryeministri, i cili doli bluf, duke thënë se do të financohen rreth 6 mijë km rrugë rurale. Zëvendëskryeministri Gazment Oketa nënvizoi se 4500 km rrugë rurale do të nisin financimin në fund të vitit 2009, ku për to nuk është gjetur ende financim. “Për këtë qëllim, Fondi Shqiptar i Zhvillimit prezantoi dje fillimin e zbatimit të projektit të ri që financohet nga Banka Botërore me vlerë 400 milionë USD për ndërtimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri. Në konferencën e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendëskryeministri Gazmend Oketa, në cilësinë e kryetarit të bordit të FSHZH-së, drejtori i Programit të Transportit të BB-së, Martin Humphreys, si edhe përfaqësues të tjerë të qeverisjes qendrore dhe lokale. “Ky është një projekt ambicioz

i qeverisë shqiptare, i mbështetur nga BB-ja dhe që do të realizohet nga FSHZH. Me anë të këtij projekti qeveria do të synojë të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend, si edhe për shtimin e aksesit ndaj shërbimeve themelore dhe tregjeve ekonomike, veçanërisht në zonat rurale”, tha Oketa. Në fund të këtij projekti parashikohet të ngrihet jo vetëm një rrjet dytësor dhe komunal i përmirësuar në mënyrë rrënjësore, por edhe një inventar i rifreskuar i të gjitha rrugëve rajonale, duke mundësuar njohjen në kohë reale të nevojave për investim dhe për mirëmbajtjen e tyre. Drejtori ekzekutiv i FSHZH, Benet Beci, foli rreth aktiviteteteve kryesore dhe hapat e ardhshëm për fillimin e punës. Synimi i FSHZH-së është lidhja e kontratave të para të punimeve civile në periudhën korrik-qershor 2008. “Projekti do të ketë ndikim në zhvillimin social e ekonomik të zonës, gjendjen ekzistuese të rrugës së propozuar, numrin e përfituesve, raportin financiar kosto/përfitim etj. Kriteret do të bëhen publike para vlerësimit dhe do të konsultohen me të

gjithë të interesuarit, në mënyrë që të arrihet një përzgjedhje sa më e mirë, janë këto disa nga kriteret kryesore për përzgjedhjen e projekteve për financim”, përfundoi Beci.

Projekti sipas BB

Deri tani, ky program do të përfshijë një shifër midis 1,000 dhe 1,500 kilometra rrugë rajonale dhe lokale, të shoqëruara me një kosto totale të tij afërsisht 200-400 milionë dollarë amerikanë. Kontributi i BB-së për këtë projekt është një kredi e IBRD prej 20 milionë USD. Megjithatë është diskutuar dhe rënë dakord paraprakisht bashkë-financimi i projektit me një numër institucionesh të tjera financiare.